



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 11

2002

Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 8871 datë 29.3.2002	Për disa ndryshime në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”.....	319
Ligj nr. 8872 datë 29.3.2002	Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.....	320
Ligj nr. 8873 datë 29.3.2002	Për sigurimin e depozitave.....	330
Dekret nr. 3277 datë 25.3.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	341
Dekret nr. 3279 datë 27.3.2002	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	342
Dekret nr. 3282 datë 5.4.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	343

Dekret nr. 3302 datë 19.4.2002	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare	344
Vendim i GjK nr.61, datë 29.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.755, datë 13.7.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr. R-17, datë 6.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	345
Vendim i GjK nr.62, datë 29.3.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.773, datë 15.3.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës; nr.1086, datë 13.11.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.942, datë 25.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomës së Këshillimit).....	347
Vendim i GjK nr.63, datë 3.4.2002	Me objekt deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese	349
Vendim i GjK nr.64, datë 4.4.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.413, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; nr.1098, datë 20.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.K-5, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	350
Vendim i GjK nr.65, datë 4.4.2002	Me objekt shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.32, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Apelit të Vlorës; nr.293, datë 9.3.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.M-44, datë 4.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.....	352
	<i>Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetasit Gëzim Bida</i>	355
	<i>Kërkesë për shpallje të vdekur të shtetases Fatime Hysa</i>	355

L I G J
Nr. 8871, datë 29.3.2002

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8379, DATË 29.7.1998 “PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHQIPËRISË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, neni 22 pika 22.2 dhe neni 23 pika 23.2 shfuqizohen.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3289, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8872, datë 29.3.2002

PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

K R E U I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është të mbështesë zhvillimin e një sistemi të përbashkët të arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, i cili mund t’u përshtatet ndryshimeve shoqërore, ekonomike e teknologjike, nevojave të tregut të punës, si dhe të mundësojë një shfrytëzim optimal të burimeve financiare, njerëzore dhe infrastrukturore.

2. Ky ligj vendos parimet themelore, strukturën, organizimin dhe administrimin e arsimit dhe formimit profesional në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në bashkëpunimin e institucioneve shtetërore, qeveritare me partnerë socialë dhe aktorë të tjerë në fushën e arsimit dhe formimit profesional.

3. Ky ligj garanton të drejtën e shprehur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për

arsimim dhe formim profesional gjatë gjithë jetës, mundësinë e kryerjes së arsimit fillestar profesional, si dhe të fitimit të njohurive profesionale të nevojshme për punësim, duke krijuar shanse të barabarta për të gjithë.

Neni 2

Objektivat e arsimit dhe formimit profesional

Ky ligj përcakton objektivat kryesore të sistemit të arsimit dhe formimit profesional, të cilat janë:

a) të zhvillojë karakteristikat personale kryesore të individit, të nevojshme për veprimtarinë e tij të ardhshme profesionale dhe ekzistencën e pavarur brenda një shoqërie të bazuar në parimet e demokracisë dhe të ekonomisë së tregut;

b) të përshtasë arsimin dhe formimin profesional në tregun e sotëm dhe të ardhshëm të punës;

c) të ofrojë dhënien e një kulture profesionale të përgjithshme dhe të një formimi profesional të specializuar, në përputhje me zhvillimin e shkencës dhe të teknologjisë, si dhe me kulturën dhe traditën kombëtare;

ç) të krijojë kushte për arsimim dhe formim profesional, me qëllim aftësimin e individit për t'iu përshtatur ndryshimeve dhe kërkesave të tregut të punës;

d) të rrisë frytshmërinë e përdorimit të infrastrukturës së sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

Neni 3

Arsimi dhe formimi profesional është publik dhe jopublik dhe garantohet nga shteti.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

a) “Sistemi i arsimit dhe formimit profesional” është sistemi që përfshin të gjitha masat dhe veprimtaritë e arsimit profesional e teknik dhe ato të formimit, të riformimit dhe të riaftësimin profesional në tregun e punës, si dhe në institucionet përgjegjëse dhe zbatuese të tyre.

b) “Arsimi profesional” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili u jep nxënësve, që kanë përfunduar arsimin e detyruar, arsimimin bazë profesional, si dhe njohuritë e shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar për një specialitet të dhënë. Arsimi profesional kryhet në shkollat profesionale, në përputhje me planet dhe programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

c) “Arsimi teknik” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili u jep nxënësve, që kanë përfunduar arsimin e detyruar, një arsimim bazë, të gjerë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehite e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e teknikut të kualifikuar, për një specialitet të dhënë. Arsimi teknik kryhet në shkollat e mesme teknike, në përputhje me planet dhe programet e miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

ç) “Formimi profesional” është element i sistemit të arsimit dhe formimit profesional, i cili përfshin formimin, riformimin dhe riaftësimin profesional, për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale, për t'iu përshtatur kërkesave të tregut të punës.

d) “Institucionet e arsimit dhe formimit profesional” janë ato institucione publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë ose mbështesin arsimin dhe formimin profesional në Shqipëri.

dh) “Ndërmarrja” është çdo subjekt fizik dhe juridik, në të cilën, sipas kushteve të saj, realizohen kurse formimi, formimi nëpërmjet punës dhe ku kryhen praktika profesionale të nxënësve si elementë të procesit të arsimit dhe formimit profesional.

e) “Nxënës” është ai person, që merr arsimim profesional e teknik në një nga shkollat e sistemit të arsimit dhe formimit profesional.

ë) “K ursant” është ai person, që merr pjesë në një program ose kurs të formimit profesional.

f) “Mësues” është ai person, i angazhuar me dhënien e mësimit teorik dhe praktik në

institucionet e akredituara të arsimit dhe formimit profesional.

g) “Instruktor” është ai person, i angazhuar me dhënien e mësimi teorik dhe praktik në qendra formimi dhe ndërmarrje të akredituara në arsimin dhe formimin profesional.

gj) “Partnerë socialë” janë organizatat që përfaqësojnë interesat e punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të cilat marrin pjesë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional dhe së bashku me institucionet administrative shtetërore punojnë për zbatimin e këtij ligji.

h) “Partnerë të tjerë” janë dhomat e tregtisë dhe të industrisë, organizatat jofitimprurëse, komunitetet e ndryshme, që marrin pjesë në sistemin e arsimit dhe formimit profesional dhe së bashku me institucionet administrative shtetërore punojnë për zbatimin e këtij ligji.

i) “Dëftesa, dëftesa e pjekurisë, certifikata e aftësisë profesionale, dëshmia dhe certifikata e kualifikimit të njohura nga shteti” janë dokumente që vërtetojnë përmbushjen, nga ana e nxënësve dhe e kursantëve, e programeve të miratuara të arsimit dhe formimit profesional.

j) “Qendra e formimit profesional” është enti publik dhe jopublik, në të cilin zhvillohen programe formimi profesional dhe praktika profesionale për nxënësit dhe kursantët, pa qëllim fitimi.

Neni 5

Përfituesit nga ky ligj

Nga ky ligj përfitojnë:

a) të gjithë nxënësit që kanë përfunduar arsimin e detyruar;

b) personat që kanë mbushur moshën 18 vjeç, që janë kërkues pune dhe/ose dëshirojnë të formohen profesionalisht;

c) grupe të veçanta, që dëshirojnë riaftësim profesional, si personat me aftësi të kufizuara, nënat me shumë fëmijë, personat nën 18 vjeç, të papunët afatgjatë, personat nga familje nën nivelin e varfërisë dhe çdo kategori tjetër që do të përcaktohet si e tillë me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6

Tipat e arsimit dhe formimit profesional

Arsimi dhe formimi profesional përbëhet nga:

a) arsimi profesional;

b) arsimi i mesëm teknik;

c) formimi profesional;

ç) forma të tjera të arsimit dhe formimit profesional që përcaktohen me ligj.

Format e organizimit të tipave të mësipërm të arsimit dhe formimit profesional përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU II

KRITERE TË PËRGJITHSHME

Neni 7

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional

Institucionet e arsimit dhe formimit profesional janë:

a) Shkollat profesionale publike dhe jopublike, të nivelit të parë dhe të dytë, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit të detyruar. Këto shkolla realizojnë përgatitjen profesionale me karakter të theksuar praktik dhe u japin nxënësve arsimimin bazë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e punëtorit të kualifikuar për një specialitet të dhënë.

b) Shkollat teknike publike dhe jopublike, të cilat ofrojnë arsimimin teknik të nxënësve pas arsimit të detyruar. Këto shkolla u japin nxënësve një arsimim bazë të gjerë profesional, si dhe njohuritë dhe shprehitë e domosdoshme për një veprimtari të kualifikuar profesionale në nivelin e teknikut të kualifikuar për një specialitet të dhënë.

c) Qendrat dhe kurset e formimit profesional, të cilat organizojnë formim, riformim dhe riaftësim profesional, për fitimin e aftësive të nevojshme profesionale për t’iu përshtatur kërkesave të

tregut të punës.

ç) Institucionet e specializuara të arsimit dhe formimit profesional për grupe të veçanta.

d) Ndërmarrjet.

dh) Institucionet e tjera publike dhe jopublike, veprimtaria e të cilave rregullohet me akte të veçanta nënligjore.

Neni 8

Regjistrimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional

Të gjitha institucionet që ofrojnë arsimin dhe formimin profesional duhet të regjistrohen në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe në Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale. Kriteret dhe rregullat përcaktohen me udhëzim të përbashkët të dy ministrave.

Neni 9

Akreditimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional

Akreditimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale në përputhje me aftësitë e këtyre institucioneve për të ofruar arsimin dhe formimin profesional. Kushtet dhe kriteret e akreditimit përcaktohen me akte të veçana nënligjore të Këshillit të Ministrave.

Neni 10

Pranimi në arsimin dhe formimin profesional

1. Në shkollat profesionale dhe në ato të mesme teknike publike dhe jopublike pranohen të gjithë individët që kanë përfunduar arsimin e detyruar dhe kanë marrë dëftesën e lirim. Kriteret e pranimeve dhe procedurat e regjistrimit vendosen me udhëzim të veçantë të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

2. Në kurset e ndryshme të formimit, të riformimit dhe të riaftësimit profesional publik dhe jopublik, të akredituar, marrin pjesë të rinjtë dhe të rriturit, të cilët pranojnë programet përkatëse të miratuara nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale. Procedurat e regjistrimit në formimin publik vendosen me udhëzim të Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 11

Kohëzgjatja në arsimin dhe formimin profesional

1. Arsimi dhe formimi profesional ka kohëzgjatje të ndryshme në varësi të tipit të tij.

2. Arsimi profesional publik dhe jopublik fillon pas mbarimit të arsimit të detyruar dhe sipas niveleve ka këtë kohëzgjatje: niveli i parë vazhdon deri në tre vjet dhe niveli i dytë vazhdon edhe dy vjet të tjerë pas nivelit të parë. Me mbarimin e nivelit të parë, krahas dëftesës së përfundimit të saj, nxënësit pajisen edhe me një certifikatë të aftësimit profesional. Në përfundim të nivelit të dytë, nxënësit marrin dëftesën e pjekurisë, certifikatën e aftësimit profesional dhe u njihet mbarimi i shkollës së mesme dhe mundësia e vazhdim të shkollës së lartë.

3. Arsimi i mesëm teknik publik dhe jopublik fillon pas mbarimit të arsimit të detyruar dhe vazhdon pesë vjet. Nxënësit që mbarojnë shkollat teknike publike dhe jopublike, krahas dëftesës së pjekurisë marrin edhe certifikatën e aftësimit tekniko-profesional dhe mund të vazhdojnë shkollën e lartë.

4. Formimi profesional publik dhe jopublik zhvillohet nëpërmjet kurseve të formimit, të riformimit dhe të riaftësimit profesional me kohëzgjatje nën tre vjet.

5. Kohëzgjatja në tipa të tjerë të arsimit dhe formimit profesional rregullohet me udhëzim të ministrit që ka në kompetencë tipin e arsimit dhe formimit profesional.

Neni 12

Kalimi nga një tip i arsimit dhe formimit profesional në një tjetër

Ndërrimi i profilit dhe kalimi nga një tip i arsimit dhe formimit profesional në një tjetër bëhet me udhëzim të përbashkët të ministrave përkatës.

Neni 13

Vlerësimi përfundimtar në arsimin dhe formimin profesional

Vlerësimi përfundimtar i nxënësve dhe i kursantëve në arsimin dhe formimin profesional publik dhe jopublik, të akredituar, bëhet në bazë të provimeve, me pjesëmarrjen edhe të partnerëve socialë. Kriteret dhe rregullat e provimeve dhe të testeve përcaktohen me udhëzim të ministrit përkatës.

Neni 14

Certifikimi

1. Sistemi i certifikimit të njohur nga shteti përfshin:
 - a) dëftesë, dëftesë përfundimi, dëftesë pjekurie, certifikatë e arsimit profesional, certifikatë e aftësisë tekniko-profesionale për nxënësit;
 - b) dëshmi dhe certifikatë për kursantët.
2. Përmbajtja, forma dhe procedurat e lëshimit të dëftesave dhe të certifikatave për nxënësit përcaktohen nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës, kurse përmbajtja, forma dhe procedurat e lëshimit të dëshmive dhe të certifikatave për kursantët përcaktohen nga ministri përkatës.

Neni 15

Këshillimi dhe orientimi në arsimin dhe formimin profesional

Me këshillimin dhe orientimin në arsimin dhe formimin profesional synohet që të ndihmohen të gjithë shtetasit në zgjedhjen e arsimit, të profesionit, të formimit, të riformimit dhe të riaftësisë profesionale më të përshtatshëm për interesat dhe mundësitë fizike e mendore të tyre. Ministrinë përkatëse nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e këtij neni.

Neni 16

Dokumentimi, informacioni dhe statistikave

Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale janë përgjegjëse për dokumentimin, për dhënien e informacionit dhe për mbajtjen e statistikave të arsimit dhe formimit profesional, sipas fushave përkatëse që ato mbulojnë. Të gjitha ministrinë e tjera, si dhe pushteti vendor janë të detyruar të japin informacion të këto dy ministri për veprimtarinë e arsimit dhe formimit profesional.

Neni 17

Personeli në arsimin dhe formimin profesional

1. Në institucionet e arsimit dhe formimit profesional angazhohet personel mësimdhënës teorik e praktik, personel drejtues dhe personel ndihmës.
2. Personeli i mësimdhënies përbëhet nga:
 - a) mësuesit e kulturës së përgjithshme;
 - b) mësuesit e kulturës profesionale;
 - c) mësuesit e praktikave profesionale;
 - ç) instruktorët.
3. Kërkesat bazë për përgatitjen fillestare dhe kualifikimin e mësuesve (shkronjat a, b dhe c të pikës 2 të këtij neni) përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, kurse për instruktorët nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 18
Ndërmarrja

Ndërmarrja shërben si vend i organizimit të kurseve të formimit nëpërmjet punës dhe si vend i realizimit të praktikave profesionale të nxënësve dhe të kursantëve. Shteti mbështet ndërmarrjet që përfshihen në sistemin e arsimit dhe formimit profesional.

Neni 19
Vlerësimi i sistemit

Mekanizmat e zhvillimit dhe të vlerësimit të sistemit të arsimit dhe formimit profesional përpunohen nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional. Vlerësimi bëhet çdo vit dhe rezultatet e tij publikohen në raportin vjetor kombëtar të arsimit dhe formimit profesional, i cili i paraqitet Këshillit të Ministrave.

KREU III
BASHKËRENDIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 20
Kriteret e përgjithshme të bashkërendimit

1. Bashkërendimi i përgjithshëm i sistemit të arsimit dhe formimit profesional publik dhe jopublik bëhet nga shteti.
2. Organizmat përgjegjës të arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri janë:
 - a) Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për arsimimin profesional dhe të mesëm teknik;
 - b) Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, për formimin profesional;
 - c) Ministrinë dhe institucionet e tjera publike dhe jopublike, të cilat duhet të bashkërendojnë punën me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës për arsimimin profesional dhe të mesëm teknik dhe me Ministrinë e Punës dhe Çështjeve Sociale për formimin profesional;
 - ç) Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional.

Neni 21
Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional

1. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional është organizëm këshillimor. Ai i sugjeron Këshillit të Ministrave politika për zhvillimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional.
2. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional bashkëkryesohet nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.
3. Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional përbëhet nga 14 anëtarë:
 - a) 2 anëtarë, përfshi ministrin, nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës;
 - b) 2 anëtarë, përfshi ministrin, nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale;
 - c) 1 anëtar nga Ministria e Financave;
 - ç) 1 anëtar nga Ministria e Ekonomisë;
 - d) 1 anëtar nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit;
 - dh) 1 anëtar nga Ministria e Shëndetësisë;
 - e) 1 anëtar nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit;
 - ë) 1 anëtar nga organizatat jofitimprurëse që zhvillojnë veprimtari në fushën e arsimit dhe formimit profesional;
 - f) 2 anëtarë nga organizatat e punëdhënësve;
 - g) 2 anëtarë nga organizatat e punëmarrësve.
4. Organizimi dhe veprimtaria e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional rregullohet me udhëzim të përbashkët të dy ministrave përkatës.

Neni 22

Kompetencat e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në fushën e arsimit dhe formimit profesional

Ministria e Arsimit dhe Shkencës:

- a) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e arsimit profesional e teknik publik, që varen nga ajo, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) miraton krijimin ose riorganizimin e institucioneve jopublike, që realizojnë arsimin profesional e teknik, si dhe propozon tek organet përgjegjëse për mbylljen e tyre, kur provohet që veprimtaria e tyre nuk përputhet me aktet përkatëse nënligjore;
- c) jep licencat për arsimin profesional e teknik, si dhe për kurset e formimit profesional në shkollat teknike e profesionale, për specialitetet që ato kanë, në përputhje me procedurat e vendosura nga Këshilli i Ministrave;
- ç) përcakton kriteret e përgjithshme për marrjen në punë, për kualifikimin dhe për certifikimin e mësuesve në arsimin profesional e teknik;
- d) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të arsimit profesional;
- dh) merr pjesë (ose bën) në testimin dhe në certifikimin e nxënësve dhe të kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional, që varen prej saj;
- e) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të arsimit teknik e profesional që varen nga ajo;
- ë) jep leje për ushtrimin e profesionit të personave fizikë në arsimin profesional.

Neni 23

Kompetencat e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale në fushën e arsimit dhe formimit profesional

Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale:

- a) krijon, riorganizon dhe mbyll institucionet e formimit profesional në varësi të saj, në përputhje me procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;
- b) jep licencat për kryerjen e veprimtarive të formimit profesional;
- c) mbikëqyr veprimtarinë e licencuar të formimit profesional dhe e mbyll këtë veprimtari, kur nuk është në përputhje me aktet përkatëse ligjore dhe nënligjore;
- ç) siguron vazhdimësinë e formimit profesional në përputhje me perspektivën e zhvillimit ekonomik, kombëtar dhe rajonal, dhe me kërkesat e tregut të punës;
- d) garanton të drejtën e individit për formimin profesional, duke lehtësuar pengesat ekonomike dhe shoqërore për vazhdimin e këtij formimi;
- dh) organizon kualifikimin e vazhdueshëm të instruktorëve të formimit profesional në sektorin shtetëror;
- e) përcakton kriteret e përgjithshme të funksionimit të institucioneve të formimit profesional;
- ë) mbikëqyr veprimtarinë e institucioneve të formimit profesional që varen nga ajo;
- f) merr pjesë (ose bën) në testimin dhe në certifikimin e kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej saj.
- g) jep lejet për ushtrimin e profesionit të personave fizikë në formimin profesional.

Neni 24

Kompetencat e ministrive të tjera dhe të institucioneve shtetërore të arsimit dhe formimit profesional

Ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore të arsimit dhe formimit profesional:

- a) krijojnë, organizojnë dhe mbyllin institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej tyre, në përputhje me procedurat ligjore;
- b) përgatisin programet e formimit dhe paraqesin kurrikulat e formimit profesional në organin përgjegjës të përcaktuar me akte nënligjore;
- c) organizojnë formimin nëpërmjet punës të punonjësve të tyre dhe rikualifikimin e mësuesve dhe të instruktorëve në institucionet përkatëse;

- ç) marrin pjesë (ose bëjnë) në testimin dhe në certifikimin e nxënësve dhe të kursantëve në institucionet e arsimit dhe formimit profesional që varen prej tyre;
- d) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve shtetërore të kualifikimit profesional;
- dh) marrin pjesë në studime të arsimit dhe formimit profesional.

Neni 25

Kompetencat e pushtetit vendor në fushën e arsimit dhe formimit profesional

Pushteti vendor:

- a) propozon hapjen dhe mbylljen e specialiteteve, të kurseve dhe të shkollave, në përputhje me nevojat e zhvillimit rajonal;
- b) kujdeset dhe mirëmban institucionet e arsimit dhe formimit profesional, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- c) hap kurse të formimit profesional me fondet e veta, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Kompetencat e partnerëve socialë

Partnerët socialë:

- a) propozojnë hapjen dhe mbylljen e specialiteteve, të kurseve dhe të shkollave të reja, në përputhje me nevojat e zhvillimit ekonomik të vendit;
- b) marrin pjesë në procesin e hartimit të standardeve kombëtare të formimit profesional;
- c) organizojnë kurse kualifikimi sipas nevojave specifike të fushave që ata mbulojnë. Certifikimi i këtyre kurseve bëhet në përputhje me procedurat e vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arsimit dhe Formimit Profesional;
- ç) marrin pjesë në komisionet e provimeve në përputhje me normat dhe procedurat e vendosura me akte nënligjore të ministrive përkatëse;
- d) ndihmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale të nxënësve dhe të kursantëve.

KREU IV

STANDARDET DHE KURRIKULAT

Neni 27

Lista dhe standardet e profesioneve

1. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me partnerët socialë, vendos një sistem të klasifikimit të profesioneve dhe të standardeve të aftësive profesionale, mbështetur në analizën e vendit të punës së popullsisë të punësuar.
2. Standardet e aftësive profesionale do të klasifikohen në nivele që të përfshijnë standardet kombëtare, industriale dhe të ndërmarrjes.
3. Lista e profesioneve dhe e standardeve të aftësive profesionale, kombëtare, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Standardet industriale dhe të ndërmarrjes do të formulohen dhe do të publikohen nga partnerët socialë.

Neni 28

Hartimi i kurrikulave

1. Këshilli i Ministrave vendos standardet për zhvillimin e kurrikulave të arsimit dhe formimit profesional në nivele të përshtatshme, mbështetur në rekomandimet e Këshillit Kombëtar të Arsimit dhe Formimit Profesional.
2. Këshilli i Ministrave, në bashkëpunim me partnerët socialë rishikon kurrikulat e arsimit dhe formimit profesional në vazhdimësi dhe në përputhje me zhvillimet ekonomike të vendit.

KREU V
FINANCIMI I SISTEMIT TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL

Neni 29
Burimet e financimit

Arsimi dhe formimi profesional publik financohet nga Buxheti i Shtetit, buxheti i pushtetit vendor, programet kombëtare dhe ndërkombëtare për arsimin dhe formimin profesional, kontributet e shoqatave të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, kontributet e dhuruesve, sponsorizimet dhe burime të tjera të lejuara nga ligji.

Neni 30
Vetëfinancimi

1. Institucionet publike të arsimit dhe formimit profesional mund të kryejnë edhe veprimtari ekonomike me përfitime financiare në fushat që kanë lidhje me zbatimin e programeve mësimore, në përputhje me dispozitat ligjore.

2. Institucionet e arsimit dhe formimit profesional së bashku me qendrat e përgatitjes praktike veprojnë si njësi ekonomike për realizimin e veprimtarive prodhuese dhe të shërbimeve, duke kontraktuar me persona fizikë dhe juridikë.

3. Krahas arsimimit dhe kualifikimit profesional të nxënësve, në shkollat profesionale e teknike publike dhe jopublike kryhen edhe kurse formimi profesional, si shërbime për llogari të të tretëve.

4. Përdorimi i të ardhurave të përftuara nga këto veprimtari bëhet në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore.

KREU VI
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 31
Shfuqizime

1. Kreu I “Parime të përgjithshme” i ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe nenet e ligjit në fjalë, ku trajtohet arsimi profesional në kuadër të arsimit të mesëm të sistemit arsimor parauniversitar, mbeten në fuqi. Nenet 33, 34, 35, 36, 37, 38, 55 pika 4 dhe 57 pika 2 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore për arsimin profesional e që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

2. Neni 5 paragrafi i dytë, neni 10 dhe neni 13 shkronjat b dhe c të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, si dhe dispozitat e tjera ligjore dhe aktet nënligjore, që lidhen me formimin profesional që janë në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 32
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktet nënligjore brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndërsa ministrat përkatës brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 33
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr. 3291, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

L I G J
Nr. 8873, datë 29.3.2002

PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë sigurimin dhe kompensimin e depozitave, si dhe krijimin, përgjegjësitë dhe veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Neni 2

Përcaktime

Për qëllimin e këtij ligji, përveçse kur përcaktohet ndryshe në këtë ligj, termat e mëposhtëm kanë kuptimin:

a) "Agjencia" është Agjencia e Sigurimit të Depozitave, e krijuar sipas dispozitave të këtij ligji;

b) "Autoriteti Mbikëqyrës" është Banka e Shqipërisë;

c) "Akt nënligjor" është akti i Autoritetit Mbikëqyrës i dalë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji;

ç) "Bankë" është personi juridik që pranon dhe grumbullon depozita ose fonde të tjera të ripagueshme për publikun dhe jep kredi, paradhënie, hua ose investon për llogari të tij, sipas licencës së dhënë nga Autoriteti Mbikëqyrës;

d) "Bankë e siguruar" është banka që pranon depozita të siguruar nga Agjencia dhe dega në Shqipëri e bankës së huaj që pranon depozita të siguruar nga Agjencia;

dh) "Degë e bankës" është njësi organizative e bankës nën varësinë e drejtorisë qendrore të saj, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari të bankës;

e) "Degë e bankës së huaj në Shqipëri" është njësi organizative e bankës, nën varësinë e drejtorisë qendrore të saj, e licencuar nga autoritetet e vendit të huaj, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari të bankës në territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas licencës së dhënë nga Autoriteti Mbikëqyrës;

ë) "Dega e bankës jashtë Shqipërisë" është njësi organizative e bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, që kryen drejtpërsëdrejti të gjitha ose disa veprimtari të bankës, drejtoria qendrore e së cilës është në territorin e Republikës së Shqipërisë;

f) "Depozitë" është teprica kreditore e fondeve në llogarinë bankare depozitë, të cilën banka detyrohet të ripagujë sipas dispozitave ligjore dhe kontraktuale në fuqi;

g) "Depozitë e siguruar" është depozita që sigurohet dhe kompesohet në mbështetje dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji;

gj) "Depozitë e pasiguar" është depozita e përjashtuar nga sigurimi dhe kompensimi i depozitave, në mbështetje dhe në zbatim të dispozitave të këtij ligji;

h) "Llogari depozitë" është llogaria në bankën e siguruar ose në degën e bankës së huaj, në të cilën vendosen fondet e depozituesit, në lekë ose në monedhë të huaj. Llogaria depozitë është e të gjitha llojeve, duke përfshirë llogarinë bankare, depozitë me afat, pa afat, likuiduese dhe atë të kursimit;

i) “Depozitues” është çdo person që, sipas përcaktimeve të këtij ligji, ka të drejtën e ripagimit për depozitën nga banka, përveç depozituesve të përjashtuar nga sigurimi dhe kompesimi i depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji;

j) “Depozitë e përbashkët” është llogaria bankare depozitë e vendosur në emër të dy a më shumë personave ose mbi të cilën dy ose më shumë persona kanë të drejtën e kryerjes së veprimeve kundrejt nënshkrimit;

k) “Depozitë e të tretëve” është llogaria depozitë, mbi të cilën personi i tretë, i ndryshëm nga personi në emër dhe për llogari të të cilit është vendosur llogaria depozitë, kryen veprime kundrejt nënshkrimit dhe nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor;

l) “Kompensim” është pagimi nga Agjencia, sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, për llogari të depozitës së siguruar;

ll) “Ndërhyrje” është vënia në likuidim e bankës së siguruar me vendim të Autoritetit Mbikëqyrës;

m) “Person” është çdo individ, rezident ose jorezident, shqiptar ose i huaj.

Neni 3

Juridiksioni

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, depozita në bankë sigurohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe asnjë bankë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, përveç depozitave në degën e bankës jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, depozitat në degën e bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë sigurohen nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji dhe asnjë degë e bankës së huaj që vepron në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk pranon dhe nuk grumbullon depozita kur nuk është e siguruar nga Agjencia konform këtij ligji.

Neni 4

Depozitat e siguruara

1. Për çdo depozitë të siguruar llogaritet teprica kreditore e llogarisë depozitë dhe interesi i llogarit deri në ditën e ndërhyrjes. Për llogaritjen e depozitës së siguruar, nga teprica kreditore e llogarisë depozitë zbritet depozita e pasiguarur së bashku me interesin e llogarit.

2. Depozitat e siguruara mund të jenë në lekë ose në monedhë të huaj.

3. Për qëllim të këtij ligji, depozitat e siguruara të çdo depozituesi për çdo bankë të siguruar, të vendosura në disa llogari depozitë, llogariten të gjitha së bashku dhe konsiderohen si një llogari depozitë e vetme. Depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes.

4. Në rastet e transformimit të bankës së siguruar, nëpërmjet bashkimit, shkrirjes, ndarjes ose nëpërmjet ndonjë mënyre tjetër, depozitat e siguruara në bankat pjesëmarrëse, deri në procesin e transformimit, mbeten të siguruara.

5. Në zbatim të këtij ligji, depozita mbetet e siguruar deri në kryerjen e kompensimit nga Agjencia, pavarësisht nga ndërhyrja ose revokimi i licencës së bankës së siguruar.

6. Sigurimi i depozitës, sipas këtij ligji, përfundon kur:

- a) depozita klasifikohet si depozitë e pasiguarur;
- b) depozita kompensohet nga Agjencia.

Neni 5

Depozitat e pasiguruara

Depozitat e mëposhtme përjashtohen nga sigurimi dhe kompensimi nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji (depozitat e pasiguruara):

a) pjesa e depozitës mbi 700 000 (shtatëqind mijë) lekë ose e njëvlerëshmjja e saj në monedhë të huaj;

b) depozitat e çdo shoqërie tregtare, personi fizik ose personi tjetër juridik;

- c) depozitat e drejtorit, të administratorëve, të debitorëve të bankës së siguruar ose të çdo depozituesi tjetër, me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me bankën në fjalë;
- ç) depozitat e çdo personi që zotëron, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të drejtën e pronësisë të një aksioneri në masën 5 për qind (pesë për qind) ose më shumë në kapitalin e bankës së siguruar ose të aksioneve me të drejtë vote të lidhur me bankën në fjalë;
- d) depozitat e kontrollorëve dhe të ekspertëve kontabël të bankës së siguruar, ose të çdo depozituesi tjetër me të njëjtin status në personat juridikë të lidhur me bankën në fjalë;
- dh) depozitat e çdo depozituesi të bankës së siguruar, që gëzon më shumë se 20 për qind (njëzet për qind) interes preferencial, të ndryshëm nga interesi i zbatuar sipas kushteve të punës për të gjithë depozituesit e tjerë të kësaj banke;
- e) depozitat e çdo personi në bankën e siguruar, që përdor llogarinë depozitë për veprimtari kriminale;
- ë) depozitat jonominative, përfshirë depozitat në letrat me vlerë të prurësit;
- f) depozitat në degën e bankës jashtë Shqipërisë;
- g) depozitat e vendosura në bankën e siguruar gjatë dhe pas ditës së ndërhyrjes në këtë bankë.

Neni 6

Kompensimi i depozitës së siguruar

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruar vetëm kur Autoriteti Mbikëqyrës ndërhyr në bankën e siguruar. Agjencia nuk kompenson depozitat e siguruar, të cilat përpara kompensimit, me pëlqimin e Autoritetit Mbikëqyrës, transferohen në një bankë tjetër të siguruar.

2. Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, si vijon:

a) Për depozitat me 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë ose më pak, 100 për qind (njëqind për qind) e depozitës së siguruar;

b) Për depozitën mbi 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë deri në 700 000 (shtatë qind mijë) lekë, 100 për qind (njëqind për qind) e pjesës 350 000 (treqind e pesëdhjetë mijë) lekë dhe 85 për qind (tetëdhjetë e pesë për qind) e pjesës së mbetur të depozitës së siguruar;

c) Për depozitën mbi 700 000 (shtatëqind mijë) lekë, 647 500 (gjashhtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë.

3. Në zbatim të pikave 2 dhe 4 të këtij neni, niveli i kompensimit për çdo depozitues llogaritet mbi shumën agregate të depozitave të siguruar të këtij depozituesi në një bankë, në ditën e ndërhyrjes, pa marrë parasysh numrin e depozitave, llojin e monedhës së depozituar ose të pagueshme, si dhe vendin në të cilin vendosen këto depozita në Republikën e Shqipërisë.

4. Për përcaktimin e shumës së depozitës së siguruar për kompensim nga Agjencia, sipas pikës 2:

a) depozitat në afat vlerësohen të përfunduara në afat në ditën e ndërhyrjes;

b) depozitat e siguruar llogariten sipas nenit 4 pika 1 të këtij ligji, duke përfshirë tepricën kreditore dhe interesin e llogaritur deri në ditën e ndërhyrjes dhe depozitat e siguruar në monedhë të huaj këmben në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e ndërhyrjes;

c) depozitat e siguruar, të mbajtura nga çdo depozitues në bankë në ditën e ndërhyrjes, agregohen. Në mbështetje dhe për zbatimin e këtij ligji, agregim është llogaritja e shumës së përgjithshme të depozitave të siguruar të një depozituesi në bankën e siguruar, duke zbritur shumën e papaguar nga depozituesi për nënshkrimin e aksioneve të kapitalit të bankës dhe shumën nga bashkimi i cilësive të kreditorit dhe të debitorit, në një të vetëm, dhe të kompensimit të detyrimeve të tjera të depozituesit në bankë sipas kontratës ose ligjit në fuqi.

5. Agjencia ka të drejtë të refuzojë kompensimin ose të kërkojë kthimin e kompensimit për depozitat e siguruar, kur e drejta për kompensim bazohet në të dhëna të pavërteta dhe mashtruese.

6. Çdo depozitues ka të drejtë të depozitojë një ankesë në Autoritetin Mbikëqyrës. Vendimi i Agjencisë zbatohet pa kufizim gjatë periudhës së ankimit dhe çdo apelimi tjetër ose procesi tjetër juridik të lidhur me apelimin. Akti i Autoritetit Mbikëqyrës ankimohet, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7

Kompensimi i depozitës së siguar dhe cedimi

1. Kompensimi për llogari të depozitave të siguruara kryhet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se tre muaj nga dita e ndërhyrjes.

2. Agjencia kompenson depozitën e siguar si vijon:

a) nëpërmjet njohjes së të drejtës së pronësisë mbi depozitën e transferuar në një bankë tjetër të siguar, deri në nivelin e kompensimit sipas dispozitave të këtij ligji;

b) nëpërmjet pagimit të shumës në lekë personit sipas nivelit të kompensimit.

3. Kur shuma që kërkohet për kompensimin e depozitave të siguruara është më e madhe sesa mjetet financiare të zotëruara nga Agjencia, atëherë përdoren mjete financiare nga Buxheti i Shtetit.

4. Me pagimin e kompensimit të depozitës së siguar, sipas dispozitave të këtij ligji, Agjencisë i cedohen të gjitha tagrat dhe të drejtat e depozituesit deri në shumën e kompensuar. Me likuidimin e bankës, pretendimet e Agjencisë renditen në radhë, së bashku me depozituesit e vegjël, sipas ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”. Veprimet ose mosveprimet në përdorimin e së drejtës dhe të tagrave mbahen nga Agjencia në emër dhe për llogari të depozituesit ose të vetë Agjencisë deri në nivelin e kompensimit të depozitave.

5. Cedimi i të drejtave dhe tagrave të depozituesve të kompensuar në Agjenci, sipas pikës 4 të këtij neni, nuk cenon të drejtat e këtyre depozituesve ndaj bankës për llogari të këtyre depozitave deri në atë masë sa teprica kreditore kalon nivelin e kompensimit të paguar nga Agjencia.

Neni 8

1. Në mbështetje dhe për zbatimin e këtij ligji themelohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave. Agjencia është person juridik publik, me qendër në Tiranë.

2. Agjencia, brenda përgjegjësisë së përcaktuar në këtë ligj, gëzon pavarësi operationale dhe financiare nga çdo subjekt tjetër.

3. Agjencia, për veprimtarinë vjetore të saj, raporton në Kuvend, në Këshillin e Ministrave dhe në Autoritetin Mbikëqyrës.

4. Agjencia shpërndahet dhe likuidohet me ligj.

5. Agjencia përjashtohet nga të gjitha tatimet dhe taksat e drejtpërdrejta.

Neni 9

Detyrimet dhe të drejtat e Agjencisë

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara deri në nivelin dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

2. Agjencia përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standardet e pranuar të menaxhimit të riskut.

3. Agjencia bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Autoritetin Mbikëqyrës për bankat e siguruara. Në mbikëqyrjen e bankave, Autoriteti Mbikëqyrës mbron interesat e Agjencisë dhe i jep asaj informacion për depozitat, për gjendjen e bankave të siguruara dhe për subjektet që kërkojnë të licencohen si bankë.

4. Agjencia bashkëpunon dhe shkëmben informacion mbi bazën e reciprocitetit për sigurimin e depozitave me organizatat përgjegjëse homologe të vendeve të tjera.

Neni 10

Organizimi dhe drejtimi

Agjencia organizohet dhe administrohet nga Këshilli Drejtues dhe drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm.

Neni 11
Detyrat e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organi më i lartë vendimmarrës për veprimtarinë e Agjencisë.
2. Ky këshill ka këto përgjegjësi:
 - a) vendos për kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - b) përcakton primet vjetore të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
 - c) përcakton kontributet fillestare të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
 - ç) mbikëqyr veprimtarinë e Drejtorit të Përgjithshëm;
 - d) miraton raportet dhe rekomandimet për publikim;
 - dh) propozon akte nënligjore për Autoritetin Mbikëqyrës;
 - e) vendos për politikat e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë;
 - ë) shqyrton buxhetin e Agjencisë, cakton nivelin e pagave për Drejtorin e Përgjithshëm dhe personelin e Agjencisë, si dhe shpërblimin për anëtarët e Këshillit Drejtues, të cilët ia paraqet për miratim Autoritetit Mbikëqyrës;
 - f) vendos për pranimin dhe përjashtimin e bankave në sigurimin e depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji;
 - g) i propozon Këshillit të Ministrave rritje të fondit themeltar dhe miraton kreditë, huatë ose donacionet për Agjencinë;
 - gj) miraton bilancin vjetor, raportet vjetore dhe raportet e tjera financiare të Agjencisë;
 - h) propozon shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues, sipas nenit 13 të këtij ligji;
 - i) miraton statutin dhe rregulloren e brendshme të Agjencisë për:
 - (i) procedurat e mbledhjeve të Këshillit Drejtues;
 - ii) strukturën organizative të Agjencisë dhe përshkrimin e detyrave të nëpunësve të Agjencisë;
 - iii) procedurën e delegimit të përgjegjësisë;
 - iv) programet vjetore të punës;
 - v) shqyrtimin dhe miratimin e kontrolleve të brendshme dhe të jashtme të Agjencisë.

Neni 12
Përbërja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga pesë anëtarë. Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen nga Autoriteti Mbikëqyrës, të propozuar si më poshtë:
 - a) dy anëtarë nga Autoriteti Mbikëqyrës;
 - b) dy anëtarë nga Ministri i Financave;
 - c) një anëtar nga bashkimi profesional i ekspertëve kontabël.
2. Anëtarët e Këshillit Drejtues duhet të jenë personat që:
 - a) janë shtetas të Republikës së Shqipërisë;
 - b) kanë arsimin e lartë ekonomik ose juridik;
 - c) kanë përvojë pune mbi shtatë vjet dhe kualifikime profesionale në çështje financiare dhe bankare;
 - ç) nuk kanë pengesa të parashikuara në nenin 13;
 - d) nuk janë punësuar nga Agjencia përveç Drejtorit të Përgjithshëm;
 - dh) nuk janë administratorë ose të punësuar në bankën e siguruar me ose pa shpërblim.
3. Afati i qëndrimit në detyrë për çdo anëtar të Këshillit Drejtues është pesë vjet, duke synuar që datat e mbarimit të këtij afati të çdo anëtari të Këshillit Drejtues, të jenë të shpërndara gjatë periudhës pesëvjeçare.
4. Përfaqësuesi i bankave të siguruara mund të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit Drejtues të Agjencisë pa të drejtë vote.

Neni 13
Shkarkimi i anëtarëve të Këshillit Drejtues

Çdo anëtar i Këshillit Drejtues, përfshirë Drejtorin e Përgjithshëm, shkarkohet nga Autoriteti Mbikëqyrës në rast se:

- a) është në pamundësi për të shërbyer në Këshillin Drejtues, sipas nenit 12 të këtij ligji;
 - b) dënohet nga gjykata për një vepër penale;
 - c) është shpallur në paaftësi paguese ose ka qenë administrator në 5 vitet e fundit në një shoqëri tregtare, e cila është shpallur në paaftësi paguese;
 - ç) ndalohet ose pezullohet nga gjykata të ushtrojë detyrën si nëpunës shtetëror ose në shërbimin publik, ose të ushtrojë veprimtarinë apo mjeshtërinë;
 - d) është në marrëdhënie bashkëshortore ose gjaku, deri në shkallë të dytë, me anëtarët e tjerë të Këshillit Drejtues të Agjencisë, ose me një anëtar të Këshillit Drejtues të bankës, ose me një administrator të bankës së siguruar ose me personin i cili zotëron më shumë se pesë për qind të aksioneve me të drejtë vote në bankën e siguruar;
 - dh) ka munguar tre ose më shumë herë, në vazhdimësi, në mbledhjet e radhës të Këshillit Drejtues, pa shkak të arsyeshëm;
 - e) është në pamundësi, fizike ose mendore, për të mbuluar funksionet e ngarkuara mbi një vit;
 - ë) shkel rëndë etikën dhe cenon interesat e Agjencisë;
 - f) jep dorëheqjen ose vdes.
2. Asnjë anëtar i Këshillit Drejtues nuk pezullohet ose shkarkohet për shkaqe të tjera.
3. Anëtarët e këshillit njoftojnë dorëheqjen me shkrim në Agjenci jo më pak se tre muaj përpara largimit.
4. Çdo vend bosh në Këshillin Drejtues zëvendësohet me emërimin e një anëtari të ri, në zbatim të nenit 12 të këtij ligji, për të shërbyer deri në përfundimin e mandatit të anëtarit të zëvendësuar.

Neni 14

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjet e Këshillit Drejtues kryesohen nga Kryetari. Anëtarët e Këshillit Drejtues zgjedhin Kryetar një nga anëtarët e këtij Këshilli. Kryetari i Këshillit Drejtues nuk është Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë.
2. Këshilli Drejtues mblidhet sa herë që kërkohet për realizimin e veprimtarisë së Agjencisë, por jo më pak se një herë në dy muaj kalendarikë. Këshilli Drejtues mblidhet me kërkesë të Kryetarit, të Drejtorit të Përgjithshëm ose të Autoritetit Mbikëqyrës, si dhe me kërkesën e jo më pak se dy anëtarëve të Këshillit Drejtues.
3. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtën e një vote. Mbledhja e këtij Këshilli zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve.
4. Vendimet e Këshillit Drejtues merren me votim të hapur, përveç rasteve kur bëhet votim për persona dhe kur Këshilli vendos ndryshe.
5. Mbledhjet e Këshillit Drejtues protokollohen. Protokolli nënshkruhet nga Kryetari dhe sekretari i Këshillit Drejtues. Sekretari nuk është anëtar i Këshillit Drejtues.
6. Kryetari i Këshillit Drejtues mbledh dhe kryeson këshillin. Në rast barazie të votave, vota e tij është përcaktuese.
7. Në mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të ftohen edhe përfaqësues të bankave të siguruara, sa herë që gjykohet e nevojshme nga Këshilli Drejtues.

Neni 15

Deklarimi i interesave

1. Që në momentin e pjesëmarrjes në Këshillin Drejtues ose të emërimit si nëpunës në Agjenci dhe për çdo vit e më pas, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe nëpunësit e Agjencisë deklarojnë pranë këtij Këshilli të gjithë interesat tregtarë, që kanë ata ose anëtarët e tjerë të familjeve të tyre. Këto deklarata bëhen sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Drejtues.

2. Kurdoherë që shtrohen për diskutim në Këshillin Drejtues çështje në lidhje me këta interesa, anëtari që ka lidhje me çështjen deklaron interesat në fillimin e diskutimit dhe nuk merr pjesë në diskutimin dhe vendimin për këtë çështje. Prania e këtij anëtari llogaritet për efekt të pjesëmarrjes në mbledhje.

Neni 16

Drejtori i Përgjithshëm

1. Drejtori i Përgjithshëm emërohet dhe shkarkohet nga Autoriteti Mbikëqyrës, si rregull, me propozimin e Këshillit Drejtues. Këshilli Drejtues miraton afatet dhe kushtet e punësimit të tij.

2. Drejtori i Përgjithshëm vepron si drejtor ekzekutiv i Agjencisë. Të drejtat dhe detyrat e Drejtorit të Përgjithshëm rregullohen në statutin e Agjencisë.

3. Drejtori i Përgjithshëm përgjigjet përpara Këshillit Drejtues për zbatimin e vendimeve dhe të detyrave të Agjencisë.

Neni 17

Konflikti i interesave

Drejtori i Përgjithshëm dhe punonjësit e Agjencisë nuk mund të hyjnë në marrëdhënie punësimi me bankat e siguruara, pavarësisht me shpërblim ose jo, përkohësisht ose pa afat.

Neni 18

Të dhënat

Asnjë person, që shërben ose ka shërbyer si anëtar i Këshillit Drejtues, drejtues a personel i Agjencisë, kontrollor i jashtëm, këshilltar, agjent a korrespondent i saj, nuk duhet që në mënyrë të paautorizuar me ligj:

- a) të lejojë zbulimin ose publikimin e të dhënave jopublike, të cilat janë përfituar nga kryerja e detyrave në Agjenci;
- b) të përdorë ose të lejojë që këto të dhëna të përdoren për përfitime personale.

Neni 19

Fondi themeltar

- 1. Fondi themeltar i Agjencisë është 400 000 000 (katërqind milionë) lekë.
- 2. Fondi themeltar është kontributi i Buxhetit të Shtetit.
- 3. Fondi themeltar nuk transferohet dhe nuk barrësohet.
- 4. Fondi themeltar, kontribut i Buxhetit të Shtetit, mund të rimbursohet në Buxhetin e Shtetit, sipas afateve dhe mënyrës së përcaktuar nga Këshilli Drejtues.
- 5. Fondi themeltar, gjatë kohës që është kontribut i Buxhetit të Shtetit, rritet me propozimin e Këshillit Drejtues dhe me miratimin e Këshillit të Ministrave.

Neni 20

Mjetet e tjera financiare

Përveç fondit themeltar, në mjetet financiare të Agjencisë përfshihen:

- kontributi fillestar i bankave të siguruara;
- primet vjetore të bankave të siguruara;
- kreditë, huatë, subvencionet dhe donacionet;
- ç) të ardhura dhe fitime kapitali të përftuara nga aktivet e saj.

Neni 21

Përdorimi i mjeteve financiare

Mjetet likuide të Agjencisë investohen vetëm në:

- a) letra me vlerë të detyrimeve në lekë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës;
 - b) letra me vlerë të detyrimeve në monedhë të huaj të emetuara nga qeveritë ose bankat qendrore, monedha e të cilave është depozituar në llogari depozitë në bankën e siguruar;
 - c) letra me vlerë të detyrimeve të emetuara nga institucionet financiare ndërkombëtare në monedhën sipas përcaktimeve të shkronjës b të kësaj pike;
 - ç) depozita në Autoritetin Mbikëqyrës.
2. Letrat me vlerë të detyrimeve të blera nga Agjencia nuk duhet të jenë me maturitet më shumë se një vit që nga momenti i fitimit të pronësisë nga Agjencia.
3. Agjencia menaxhon mjetet e saj financiare me qëllim që:
- a) të eliminojë shpenzimet e pajustificuara administrative dhe operacionale;
 - b) të menaxhojë mjete financiare në investime në instrumente financiare me nivel të pranuar rreziku dhe shlyerjeje;
 - c) të garantojë plotësimin, në çdo kohë, të nevojave për mjete financiare likuide të Agjencisë;
 - ç) të zvogëlojë koston e oportunitetit dhe minimizimin e rrezikut të zhvleftësimit të mjeteve financiare të Agjencisë nga luhatja në këmbimet valutore.
 - d) të shlyejë në kohë detyrimet.

Neni 22 Viti financiar

Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

Neni 23 Pranimi dhe përfundimi i sigurimit të depozitave

1. Subjektet që aplikojnë për licencë bankare në Autoritetin Mbikëqyrës kërkojnë njëkohësisht në Agjenci sigurimin e depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji. Aplikimi duhet të jetë në formën e përcaktuar dhe të japë informacion sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti Mbikëqyrës. Kërkesa bëhet sipas rregullave të përcaktuara nga Autoriteti Mbikëqyrës. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruet i paraqiten Autoritetit Mbikëqyrës nga Agjencia.
2. Agjencia dhe Autoriteti Mbikëqyrës konsultohen me njëri-tjetrin përpara dhënies së licencës bankare kërkuar.
3. Agjencia miraton kërkesën për sigurimin e depozitave jo më vonë se tre ditë pune nga dhënia e licencës bankare nga Autoriteti Mbikëqyrës. Me pranimin e kërkesës Agjencia lëshon certifikatë për sigurimin e depozitave.
4. Çdo bankë, kërkesa e së cilës pranohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, paguan kontribut fillestar në Agjenci jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dhënia e licencës bankare nga Autoriteti Mbikëqyrës. Kontributi fillestar është 0,5 për qind e kapitalit të nënshkruar të bankës. Kontributi fillestar paguhet njëherësh në lekë në llogarinë e Agjencisë në Autoritetin Mbikëqyrës.
5. Sigurimi i depozitës në bankën e siguruar përfundohet nga Agjencia kur:
 - a) Autoriteti Mbikëqyrës njofton me shkrim ndërhyrjen në bankën e siguruar;
 - b) Autoriteti Mbikëqyrës revokon licencën bankare të bankës së siguruar.
6. Agjencia, jo më vonë se 24 orë nga vendimi për përfundimin e sigurimit të depozitës së bankës, njofton me shkrim Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankën. Njoftimi i Agjencisë publikohet në Fletoren Zyrtare dhe të paktën në një gazetë me tirazh më të madh.

Neni 24 Primi vjetor

1. Çdo bankë e siguruar i paguan Agjencisë primin vjetor të sigurimit të depozitës.
2. Për çdo bankë, primi vjetor i sigurimit të depozitës është 0,5 për qind e mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar.
3. Agjencia mund të rrisë primin vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në 0,7 për

qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar. Rritja e primit vjetor bëhet me akt nënligjor për të gjitha bankat e siguruara.

4. Agjencia mund të ulë primin vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në 0,1 për qind të mesatares aritmetike të shumës së depozitave të siguruara që janë regjistruar në bankë në fund të çdo dite pune të tremujorit të fundit të vitit të shkuar, por vetëm nëse mjetet financiare të Agjencisë janë jo më pak se 5 për qind të mesatares së këtyre depozitave. Ulja e primit vjetor bëhet me akt nënligjor për të gjitha bankat e siguruara.

5. Primi vjetor paguhet me këste në çdo tre muaj kalendarikë, por jo më vonë se 15 ditë kalendarike pas përfundimit të çdo tremujori. Për çdo vit me pagimin e këstit të parë tremujor, çdo bankë e siguruar i paraqet Agjencisë deklaratën e llogaritjes së primit sipas kërkesave të Agjencisë.

6. Paga e primit bëhet në lekë në llogarinë e Agjencisë në Autoritetin Mbikëqyrës.

7. Primi i parë vjetor i bankës së porsalicencuar llogaritet mbi bazën e depozitave të regjistruara përgjatë 12 muajve të parë të veprimtarisë së kësaj banke. Vlerësimi i depozitave bankare të regjistruara për bankën e porsalicencuar bëhet nga Autoriteti Mbikëqyrës. Primi i parë vjetor i bankës së porsalicencuar vlerësohet proporcionalisht me periudhën e mbetur nga momenti i licencimit nga Autoriteti Mbikëqyrës.

8. Pavarësisht nga kërkesat e pikës 5, me kërkesën e Agjencisë, për raste të veçanta dhe me miratim të Autoritetit Mbikëqyrës, primi vjetor mund të paguhet përpara afatit.

Neni 25

Kontabilizimi i kontributeve dhe i primeve të bankave

1. Kontributet fillestare dhe primet vjetore llogariten si shpenzime të bankave të siguruara.
2. Kontributet fillestare dhe primet vjetore nuk rimbursohen.

Neni 26

Përfashtimi dhe dënimi

1. Agjencia përjashton bankën e siguruar nga sigurimi i depozitave, kur bankës së siguruar i revokohet licenca për ushtrimin e veprimtarisë bankare.

2. Agjencia propozon dhe Autoriteti Mbikëqyrës merr masa ndëshkimore për bankën e siguruar, në rastet:

a) kur nuk paguan kontributin fillestar dhe primin vjetor pas tre muajve nga njoftimi i fundit i Agjencisë, por jo më vonë se gjashtë muaj nga njoftimi i parë;

b) kur deklaron dhe komunikon të dhëna të pavërteta dhe të gabuara;

c) kur u komunikon depozituesve dhe të tretëve të dhëna të pavërteta, sipas nenit 30 të këtij ligji;

ç) kur informon për sigurimin e depozitave në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Për përjashtimin e bankave të siguruara, të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, Agjencia duhet:

a) të njoftojë bankën e siguruar, paraprakisht, por jo më vonë se 30 ditë nga vënia re e shkeljes;

b) të njoftojë Autoritetin Mbikëqyrës.

4. Agjencia detyrohet të njoftojë, në mënyrë të plotë dhe të detajuar, Autoritetin Mbikëqyrës për përjashtimin e bankës së siguruar, brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së vendimit të përjashtimit.

Neni 27

E drejta për informacion

1. Në zbatim të dispozitave të këtij ligji, për realizimin e veprimtarisë dhe të detyrave të saj, Agjencia kërkon të dhëna nga bankat e siguruara dhe Autoriteti Mbikëqyrës. Autoriteti Mbikëqyrës dhe bankat e siguruara bashkëpunojnë dhe japin të dhënat e kërkuara nga Agjencia.

2. Agjencia informon rregullisht Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankat e siguruara mbi politikat e sigurimit të depozitave, gjendjen financiare dhe për buxhetin e saj.

Neni 28

Kontabiliteti dhe raporti financiar i Agjencisë

1. Agjencia mban llogari e regjistra financiarë, që në çdo kohë duhet të pasqyrojnë në mënyrë të saktë gjendjen financiare të Agjencisë, në përputhje me ligjin “Për kontabilitetin” dhe me standardet ndërkombëtare.
2. Agjencia përgatit raportin dhe llogaritë financiare në fund të çdo viti financiar.
3. Raporti vjetor dhe dokumentet financiare të kontrolluara të Agjencisë i paraqiten Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Këshillit të Ministrave dhe Autoritetit Mbikëqyrës jo më vonë se tre muaj pas përfundimit të çdo viti financiar.

Neni 29

Kontrolli

1. Llogaritë dhe regjistrat e Agjencisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të specializuar, që caktohen nga Këshilli Drejtues.
2. Agjencia kontrollohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Neni 30

Informimi i publikut

1. Bankat e siguruara nuk reklamojnë depozitat e siguruara mbi shumat e siguruara, të përcaktuara në këtë ligj.
2. Çdo bankë e siguruar dhe degë e bankës detyrohen të informojnë depozituesit për:
 - a) sigurimin e depozitës;
 - b) masën e kompensimit nga Agjencia;
 - c) kushtet dhe afatet e pagimit të kompensimit;
 - ç) procedurat e sigurimit dhe të kompensimit të depozitës;
 - d) rolin dhe qëllimin e veprimtarisë së Agjencisë.
3. Informacioni sipas pikës 2 publikohet periodikisht në kushtet e punës për depozitat dhe shpallet në mjediset publike të bankës, si dhe përfshihet në kushtet e punës në marrëdhënie me klientët.

Neni 31

Dispozitë tranzitore

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të gjitha depozitat në banka sigurohen sipas dispozitave të këtij ligji.
2. Të gjitha depozitat që ndodhen në Bankën e Kursimeve deri në datën 31 mars 2002 sigurohen në masën 100 (njëqind) për qind deri në kohën e maturimit të tyre, pavarësisht nga vlefata që kanë.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji, emërohen në mbështetje të nenit 12 të këtij ligji, respektivisht si më poshtë:
 - a) një anëtar nga Ministri i Financave, për 4 (katër) vjet;
 - b) një anëtar nga Ministri i Financave, për 1 (një) vit;
 - c) një anëtar nga Autoriteti Mbikëqyrës, për 5 (pesë) vjet;
 - ç) një anëtar nga Autoriteti Mbikëqyrës, për 2 (dy) vjet;
 - d) një anëtar nga bashkimi profesional i ekspertëve kontabël, për 3 (tre) vjet.
4. Jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Agjencia njofton çdo bankë për politikën e sigurimit të depozitave dhe këshillon çdo bankë për shumën e kontributit dhe të primit vjetor fillestar që paguhet nga banka për Agjencinë. Shuma e primit fillestar vjetor është proporcionale me periudhën e mbetur të vitit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 32

Aktet

1. Ngarkohet Autoriteti Mbikëqyrës të nxjerrë aktet e propozuara nga Agjencia, në mbështetje dhe për zbatim të këtij ligji.

2. Të gjitha aktet e Agjencisë bëhen me shkrim dhe shpallen në Fletoren Zyrtare përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Autoriteti Mbikëqyrës lëshon rekomandime për bankën e siguruar me propozim të Agjencisë për qëllimin e këtij ligji.

Neni 33

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3288, datë 11.4.2002 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

D E K R E T

Nr. 3277, datë 25.3.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Helidon Jonuz Amann (Vuçetaj)
2. Arben Gani Murati
3. Bismilah – Da Arben Murati (Notaj)
4. Jasinn Arben Murati (Notaj)
5. Armina Edmond Sulejmani
6. Edlira Hqmet Remilli (Rexha)
7. Gabriela Ali Remilli
8. Alan Ali Remilli
9. Bledar Kristaq Dollaku
10. Edmond Mikel Garuli
11. Entela Jonuz Trimi (Cako)
12. Jenny Edmond Cako
13. Grace Edmond Cako

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 3279, datë 27.3.2002

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 24 dhe 19 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U rrijepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Nikoll Gjok Neçaj
2. Nazmi Asip Sulejmani
3. Lavdiqe Filip Sulejmani
4. Majlinda Nazmi Sulejmani
5. Mira Nazmi Sulejmani
6. Gëzim Nazmi Sulejmani
7. Arian Nazmi Sulejmani
8. Beneretë Hasan Zenelaj
9. Mete Mezan Cufë
10. Drita Tefik Cufë

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 3282, datë 5.4.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Amarildo Rajmond Lazri
2. Naxhi Myfit Feka
3. Joy Naxhi Feka
4. Enkeleda Haxhi Feka (Qello)
5. Andreas Qirjako Mino
6. Irma Myzafer Rrasa
7. Juna Andreas Mino
8. Ilir Xhemal Çiba (Ciba)

9. Claudia Ilir Çiba (Ciba)
10. Laura Ilir Çiba (Ciba)
11. Flutura Halil Shehu (Shehu)
12. Leonard Hajredin Kurani
13. Osman Sulejman Noka
14. Arben Murat Gjergji
15. Alban Pëllumb Ymeri
16. Shpresa Fadil Golemi (Sora)
17. Orjola Etmond Vejseli
18. Marilinda Pavllo Elgert (Konomi)
19. Alban Bujar Çekani
20. Klaus Alban Çekani
21. Entela Agron Çekani (Dule)
22. Siolita Staver Shengjini (Çuko)
23. Besmir Beqir Shengjini
24. Esmeralda Aleksandri Laho
25. Fabian Hair Cani
26. Lauren Lauro Fabian Cani
27. Alketa Lili Fugu (Liko)
28. Megi Mirand Fugu
29. Vullnet Tanush Como (Çomo)
30. Hajrie Vesel Como (Zela)
31. Bledar Luigj Sokoli
32. Valentin Paulin Pauli
33. Alma Spiro Pauli (Simaku)
34. Klaudio Valentin Pauli
35. Maria-Tereza Valentin Pauli

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

D E K R E T
Nr. 3302, datë 19.4.2002

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92 pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Berrneta Fehta Ritter (Xhaxhaj)
2. Erdi Besnik Petrela
3. Nikolin Gjon Bazhella
4. Ardjan Embrulla Kaso
5. Marjeta Vlash Scheurer (Prifti)

6. Ferdinand Ferik Merdani
7. Musa Fadil Xhakoni
8. Ujbie Bardhul Shehu
9. Shefqet Ramazan Elezi
10. Sara Shefqet Elezi
11. Etleva Ramiz Elezi (Lekaj)
12. Atland Sotiraq Abeshi
13. Arian Vesel Buri
14. Jürgen Arian Buri
15. Frida Koli Buri (Kurila)
16. Arnilda Arian Buri
17. Ilir Arian Buri
18. Alfons Gjon Shpati
19. Migerta Myrto Bylbyli
20. Haxhi Hysen Dibra
21. Rezart Avdyl Allko
22. Minire Osman Zogla
23. Edmond Ismet Bellova
24. Linda Edmond Bellova
25. Emma Edmond Bellova
26. Eriton Namik Nanaj
27. Behar Ramiz Rohleder (Kovaçi)
28. Donika Osman Vorfa (Spahiu)
29. Era Jup Vorfa
30. Anda Jup Vorfa
31. Roland Naim Vreto
32. Nensi roland Vreto
33. Ines Roland Vreto
34. Dhurata Sulejman Vreto (Maqellara)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Rexhep Meidani

V E N D I M
Nr. 61, datë 29.3.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Zija Vuci	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 15.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.27 Akti që i përket:

KËRKUES: RIZA MULLETI, përfaqësuar nga avokat Fatmir Bimbashi, me deklaram.

SUBJEKTE Të INTERESUARA:

1. SALI ANGONI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklaram.
2. ENGJELL ANGONI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklaram.
3. KIMETE ÇAUSHI, përfaqësuar nga avokat Jusuf Alibali, me deklaram.
4. NEZAQET DULI, përfaqësuar nga i biri, Bashkim Duli.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.755, datë 13.7.1999 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.R-17, datë 6.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42 e 11/2 të Kushtetutës.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtuar këto shkaqe:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dalë jashtë kompetencave të veta. Ai ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave nga gjykatat e shkallëve më të ulta, madje ka pranuar edhe prova të tjera, të cilat nuk janë marrë parasysh nga këto gjykata.

- Konkluzioni i tij është kontradiktor, sepse nga njëra anë pranon që trualli prej 24 m2 nuk është i lirë, nga ana tjetër thotë se gjysma e tij që nuk ndodhet mbi trotuar është e lirë. Në qoftë se është kështu, për këtë pjesë, Kolegji duhej të pranonte dhe jo të rrëzonte padinë.

- Parregullsia e këtij procesi konsiston në faktin se Kolegji Civil ka vendosur rrëzimin e kësaj padie edhe për mungesë legjitimitimi, në një kohë që në ngritjen e saj kërkuesi ka interes. Kjo për arsye se së bashku me dyqanin ai ka blerë me truallin, i cili është i regjistruar në hipotekë.

- Rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor është edhe vendimi i Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Çështjen ky Kolegj nuk duhej ta zgjidhte në Dhomën e Këshillimit me mospranim të rekursit, por duhej ta kalonte për shqyrtim në seancë gjyqësore, përderisa në këtë rekurs kërkuesi ka ngritur probleme ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Zija Vuci, përfaqësuesit e kërkuesit dhe të subjekteve të interesuara si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave pranë Bashkisë së Tiranës u ka kthyer subjekteve të interesuara, Sali Angoni, etj., godinën e tyre ish-pronë private e ndodhur kjo në Rrugën e “Durrësit”, Tiranë.

Mbi këtë bazë, ata i janë drejtuar gjykatës duke kërkuar detyrimin e kërkuesit, Riza Mulleti, që t’u lirojë e dorëzojë atyre truallin prej 24 m2 mbi të cilin ndodhet kioska e privatizuar prej tij në vitin 1992. Kërkuesi në këtë gjykim ka ngritur kundërpadi duke kërkuar detyrimin e tyre për njohjen e tij pronar mbi këtë sipërfaqe trualli.

Gjykata e Rrethit të Tiranës me vendimin nr.1849, datë 13.5.1998, ka vendosur pranimin e padisë dhe rrëzimin e kundërpadisë. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.1299, datë 25.9.1998, ka prishur vendimin e gjykatës së faktit duke vendosur rrëzimin e padisë së subjekteve të interesuara dhe pranimin e kundërpadisë së kërkuesit. Kundër këtij vendimi subjektet e interesuara kanë ushtuar rekurs në Gjykatën e Lartë. Kolegji Civil i kësaj Gjykate, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin nr.755, datë 13.07.1999, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit në pjesën që ka rrëzuar padinë dhe ndryshimin e tij në pjesën tjetër duke rrëzuar si të pabazuar edhe kundërpadinë.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar me rekurs në interes të ligjit vetëm kërkuesi Riza Mulleti. Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.R-17, datë 6.6.2001, ka vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e këtij rekursi si të pabazuar në ligj.

Në kundërshtim me sa ka pretenduar kërkuesi, nga përmbajtja e vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë del se kjo instancë gjyqësore shqyrtimin e çështjes e ka përqëndruar vetëm në kontrollin e ligjshmërisë së vendimit të Gjykatës së Apelit. Konkluzionet e tij ky Kolegj i ka bazuar në ato prova që janë administruar në gjykimin e shkallës së dytë, pa u bërë atyre një vlerësim të ri ose të ndryshëm. Madje, ashtu si gjykata e apelit edhe Kolegji Civil kanë pranuar se trualli objekt konflikti nuk është truall i lirë, pasi ky send ndodhet në përdorim publik.

Është kjo arsyeja nga e cila është nisur Kolegji Civil për të lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit në pjesën që rrëzonte padinë e subjekteve të interesuara duke pranuar edhe mungesën e legjitimitetit të tyre në ngritjen e kësaj padie.

Mbi këtë bazë, ky Kolegj ka ndryshuar edhe pjesën tjetër të këtij vendimi duke rrëzuar edhe kundërpadinë e kërkuesit. I ndodhur përpara kësaj situate, Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke iu përmbajtur objektit të rekursit të ushtruar vetëm nga kërkuesi dhe jo edhe nga subjektet e interesuara, ka vendosur në Dhomën e Këshillimit mospranimin e këtij rekursi.

Pretendimet e tij se problemeve që ai ka ngritur në këtë rekurs duhet t'u jepej përgjigje në seancë gjyqësore nuk janë të bazuara. Ato nuk kanë të bëjnë me asnjërin prej shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile, prandaj me të drejtë Kolegji Seleksionues ka vendosur të mos e kalojë këtë çështje për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara. Në këto rrethana, vendim i tij, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, nuk përmban elementë të një procesi jo të rregullt ligjor.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", njëzëri,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr. 62, datë 29.03.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Tefta Zaka	Anëtare e “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 28.12.2001 dhe 5.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.205/9 Akti që i përket:

KËRKUES: MUHARREM META, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. DIDIN SALIU, përfaqësuar nga avokat Vasil Plaku.
2. ENTI I KOMBETAR I BANESAVE, DEGA TIRANE, në mungesë.
3. INSTITUTI I INTEGRIMIT POLITIK, në mungesë.
4. BLENDAR META, përfaqësuar nga avokat Haki Kraja.
5. PRANVERA META, në mungesë.
6. LINDITA META, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.773, datë 15.3.1999 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës; nr.1086, datë 13.11.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës dhe nr.942, datë 25.7.2001 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhomës së Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 134/g të Kushtetutës dhe nenet 27-30 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Për shfuqizimin e këtyre vendimeve kërkuesi ka parashtruar si shkak parregullsinë e procesit ligjor të zhvilluar nga gjykatat e të gjitha shkallëve. Kjo parregullsi, sipas tij, konsiston në këto drejtime:

- Në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë ka patur tri shkelje ligjore, sipas nenit 472/a të Kodit të Procedurës Civile, por Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, në vend që të kalonte çështjen për gjykim ka vendosur mospranimin e rekursit;

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës ka dhënë vendim në favor të subjektit të interesuar, Didin Saliu, megjithëse ky i fundit kundërshtimin e të tretit e ka bërë jashtë afateve procedurale prekluzive.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Subjekti i interesuar, Didin Saliu, duke patur statusin e të përndjekurit politik dhe duke qenë i pastrehë ka lidhur me Entin Kombëtar të Banesave kontratën noteriale për kalimin e pronësisë së një apartamenti me nr.1565 Rep., nr.315 Kol.; datë 12.5.1997 dhe e ka regjistruar këtë kontratë në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluatshme (Zyrën e Hipotekës) me nr.2709, datë 13.5.1997.

Pas vendimit nr.2930, datë 17.6.1997 të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, me të cilin është konstatuar pavlefshmëria e kontratës së shitblerjes së banesave midis Entit Kombëtar të Banesave, dega e Tiranës, dhe personave të tretë (pa u përcaktuar këta persona), kërkuesi, Muharrem Meta, së bashku me subjektet e interesuara Bledar, Pranvera e Lindita Meta, më datën 15.10.1997 lidhën kontratë shitblerjeje për apartamentin në pronësi të Didin Saliut me Entin Kombëtar të Banesave, dega Tiranës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës, me vendimin nr.773, datë 15.3.1999, ka pranuar padinë e subjektit të interesuar, Didin Saliu, kundër Entit Kombëtar të Banesave Tiranë, Institutit të Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë, Shoqatës Kombëtare të të Përndjekurve Politikë dhe Muharrem, Pranvera, Bledar e Lindita Meta. Me këtë vendim kjo gjykatë ka prishur vendimin nr.2930, datë 17.6.1997 të gjykatës së rrethit dhe ka konstatuar pavlefshmërinë e kontratës së shitblerjes së familjes Meta duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme.

Mbi ankimin e kërkuesve, Muharrem Meta, etj., Gjykata e Apelit të Tiranës, me vendimin nr.1086, datë 13.11.2000, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Tiranës nr.773, datë 15.3.1999, ndërsa Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në Dhomën e Këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit si të pabazuar në ligj.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, Gjykata Kushtetuese konstaton se vendimet gjyqësore të sipërcituara janë rezultat i një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42/1 të Kushtetutës. Në zbatim të Kodit të Procedurës Civile, gjykata e apelit ka verifikuar pretendimet e kërkuesit dhe ka rezultuar se subjekti i interesuar, Didin Saliu, nuk ka patur në pronësi as sipërfaqe toke bujqësore dhe

as banesë tjetër, prandaj ka marrë autorizim për banesë si i përndjekur politik nga organet shtetërore, ka lidhur kontratë dhe e ka regjistruar pronën në zyrën e hipotekës.

Në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë kërkuksi ka ngritur pretendime për zbatimin e interpretimin e ligjit mbi bazën e rivlerësimit të provave. Ky Kolegj nuk e ka kaluar çështjen për gjykim duke u shprehur se nuk janë shkaqet e parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile. Edhe në vendimin e Kolegjit Civil nuk gjenden elementet e procesit jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues, sepse vlerësimi apo rivlerësimi i provave nuk është kompetencë e këtij Kolegji por e gjykatave të rrethit dhe të apelit.

Pretendimi tjetër i kërkuksit se kundërshtimi i të tretit është bërë jashtë afateve procedurale prekluzive jo vetëm që nuk është ngritur në Kolegjin Civil, por vjen në kundërshtim edhe me interpretimin që kanë bërë Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si organi kompetent për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I :

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M

Nr. 63, datë 3.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 3.4.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.79 Akti që i përket:

KËRKUES:TEFTA ZAKA.

OBJEKTI: Deklarimi i mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 128 pika 2 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi administroi kërkesën për dorëheqje të zonjës Tefta Zaka, anëtare e Gjykatës Kushtetuese,

V Ë R E N:

Zonja Tefta Zaka, anëtare e Gjykatës Kushtetuese, në datën 29.3.2002 ka deklaruar se jep dorëheqjen nga funksioni që mban.

Gjykata Kushtetuese konstatoi faktin e dorëheqjes së saj dhe e gjeti atë të bazuar në nenin 127 pika “ç” të Kushtetutës.

Duke qenë kështu, ajo çmon se konformë pikës 2 të këtij neni, duhet deklaruar mbarimi i këtij mandati.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 127 pika 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 9 pika 2 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, të zonjës Tefta Zaka.
- Ky vendim është përfundimtar dhe i formës së prerë.

V E N D I M

Nr. 64, datë 4.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 28.2.2002, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.38 Akti që i përket:

KËRKUES: KUJTIM SKARA, përfaqësuar nga avokat Baftjar Rusi, me prokurë.

SUBJEKTE TE INTERESUARA:

1. MINISTRIA E RENDIT PUBLIK, përfaqësuar nga Besnik Muçmataj.
2. KOMISARIATI I POLICISË, BULQIZË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.413, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; nr.1098, datë 20.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.K-5, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 e 131/f të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar si shkaqe për shfuqizimin e vendimeve nga Gjykata Kushtetuese:

- Nuk i është krijuar mundësia të marrë pjesë në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Apelit të Tiranës sepse ky gjykim u zhvillua 1(një) muaj para ditës së caktuar.

- Gjykimi i çështjes në apel në mungesë të tij nuk i ka dhënë mundësi të paraqesë provat për të mundësuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së rrethit.

- Gjykata e Lartë, në dy vendimet e saj, duke mospranuar rekursin dhe duke mos kaluar çështjen për gjykim, ka zbatuar keq ligjin material e procedural dhe i ka shkelur të drejtat për një proces të rregullt dhe të drejtë, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuar, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Matit me vendimin nr.11, datë 31.1.2000 ka vendosur pranimin e padisë së kërkuar Kujtim Skara kundër subjekteve të interesuara, Ministrisë së Rendit Publik dhe Komisarariatit të Policisë Bulqisë, duke anuluar urdhrin nr.765/1, datë 18.3.1999 të Ministrit të Rendit Publik për nxjerrjen e kërkuar në lirim.

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim subjekti i interesuar, Komisarati i Policisë Bulqizë.

Gjykata e Apelit të Tiranës, ka caktuar gjykimin e çështjes në 5.6.2000, duke e shpallur këtë sipas Kodit të Procedurës Civile në listën e çështjeve për gjykim. Në të vërtetë, gjykimi nuk u zhvillua në datën e mësipërme, por më 5.5.2000, pra 1(një) muaj më parë, duke njoftuar për këtë datë vetëm ankuesin, Komisaratin e Policisë Bulqizë, i paditur në atë gjykim.

Në seancën gjyqësore është paraqitur vetëm ankuesi dhe gjykata e apelit, pasi ka dëgjuar pretendimet e këtij të fundit, ka ndryshuar vendimin e gjykatës së rrethit dhe i ka rrëzuar padinë e kërkuar.

Gjykata e Apelit të Tiranës, Kolegji Civil (Dhoma e Këshillimit), ashtu edhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë vendosur mospranimin e rekursit pa kaluar çështjen për gjykim, kanë zhvilluar proces jo të rregullt ligjor në kuptim të neneve 33/1 e 42/1 të Kushtetutës.

Gjykata e Apelit ka gjykuar çështjen pa siguruar një gjykim kontradiktor dhe pa dëgjuar edhe kërkuar si palë në gjykim. Në këtë mënyrë ajo ka shkelur parimet e normat kushtetuese që garantojnë realizimin e të drejtës së mbrojtjes në gjyq. Para marrjes së vendimit, ajo duhet të dëgjonte drejtpërdrejt pretendimet e argumentet e çdo pale, aq më tepër që sipas nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile Gjykata e Apelit jo vetëm mban parasysh dispozitat për procedurën e gjykimit në shkallë të parë, por ka në kompetencë, që me kërkesën e palëve ose kryesisht të përsëritë tërësisht ose pjesërisht hetimin gjyqësor si dhe të marrë prova të reja.

Në Kolegjin Civil dhe në Kolegjin Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë kërkuar si ngritur pikërisht këto shkelje të rënda të rregullave procedurale, sipas neneve 472/1 e 467/ç të Kodit të Procedurës Civile, por këto kolegje në vend që t'i jepnin përgjigje pretendimit të kërkuar për mosnjoftimin e datës së gjykimit në Gjykatën e Apelit, kanë vendosur mospranimin e rekursit pa kaluar çështjen për gjykim.

Në këto rrethana, vendimet e mësipërme të këtyre gjykatave duhet të shfuqizohen si antikushtetues dhe çështja t'i dërgohet për rigjykim Gjykatës së Apelit të Tiranës.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të neneve 131/f të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

V E N D O S I:

- Shfuqizimin si antikushtetues të vendimeve nr.413, datë 5.5.2000 të Gjykatës së Apelit të Tiranës; nr.1098, datë 20.11.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit) dhe nr.K-5, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim Gjykatës së Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

V E N D I M
Nr. 65, datë 4.4.2002

“NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “““
Alfred Karamuço	Anëtar i “““
Kristofor Peçi	Anëtar i “““
Kujtim Puto	Anëtar i “““
Petrit Plloçi	Anëtar i “““
Sokol Sadushi	Anëtar i “““
Gjergj Sauli	Anëtar i “““

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 23.11.2001, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.196/7 Akti që i përket:

KËRKUES: MARIE SALLATA, OLLGA CICI, VASILIQI AGARI, KRISANTHI FURXHI, MIHAL NAQO, KIÇO NAQO, përfaqësuar nga avokat Petraq Çurri, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. MINA NAQO.
2. SPIRO NAQO, përfaqësuar nga avokat Syrja Dosti, me prokurë.
3. MARTHA XHUFKA.
4. BASHKIA VLORE, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.32, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Apelit të Vlorës; nr.293, datë 9.3.2000 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe nr.M-44, datë 4.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1, 131/f, 142/1 dhe 146/2 të Kushtetutës.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimeve të përmendura në objektin e kërkesës, për këto shkaqe:

- Gjykata e Apelit të Vlorës, vendimin nr.22, datë 14.7.1999 e ka marrë pa zbatuar detyrën e caktuar në vendimin nr.1327, datë 24.11.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit, për thirrjen dhe pyetjen e trashëgimtares Martha Xhufka, duke shkelur nenet 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenin 42/1 të Kushtetutës si dhe duke vepruar në kundërshtim me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.88, datë 7.12.2000 të dhënë për një rast analog.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në marrjen e vendimit nr.293, datë 9.3.2000 ka qenë i njëanshëm, sepse një prej gjyqtarëve kishte marrë pjesë në dhënien e vendimit nr.1321, datë 24.11.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit që i përket të njëjtës çështje, duke vepruar në kundërshtim me nenin 74/2 të Kodit të Procedurës Civile me nenin 42/1 të Kushtetutës si dhe në kundërshtim me qëndrimet e mbajtura në vendimet nr.43, datë 4.6.1999 dhe nr.19, datë 18.4.2000 të Gjykatës Kushtetuese.

- Gjykata e Lartë, duke mos shpallur ditën e gjykimit të çështjes dhe përbërjen e trupit gjykues të Dhomës së Këshillimit, u ka hequr palëve në proces mundësinë e paraqitjes së kërkesave përkatëse lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve, në bazë të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 46/2 të Kushtetutës.

- Vendimi nr.293, datë 9.3.2000 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe vendimi nr.M-44, datë 4.6.2001 i Kolegjit Seleksionues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk kanë fare

pjesën arsyetuese dhe si të tilla, vijnë në kundërshtim me nenin 142 të Kushtetutës.

- Ekspertët kanë patur mendime të ndryshme. Midis mendimit të shumicës së ekspertëve dhe provave që ndodhen në dosje ka alogjizëm. Mina Naqo dhe Martha Xhufka pranojnë bashkëpronësinë dhe të gjitha provat e tjera flasin në favorin e padisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Gjergj Sauli, përfaqësuesit e kërkuësve, të subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

Me vendimin nr.22, datë 14.7.1999 të Gjykatës së Apelit të Vlorës, kërkuësve u është rrëzuar padia e ngritur kundër subjekteve të interesuara me objekt njohjen e bashkëpronësisë mbi një shtëpi banimi dykatëshe të ndodhur në Lagjen “4 Heronjtë” të qytetit të Vlorës.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.293, datë 3.9.2000 në Dhomën e Këshillimit, vendosi mospranimin e rekursit të paraqitur prej kërkuësve, duke e konsideruar atë si të pabazuar në ligj. Edhe Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.M-44, datë 4.6.2001, vendosi në Dhomën e Këshillimit mospranimin e rekursit paraqitur prej paditsave, për mungesë të shkaqeve ligjore të parashikuara në nenet 472 e 473 të Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuëset pretendojnë se vendimet e mësipërme të gjykatave janë antikushtetues, por nga shqyrtimi i çështjes në seancë plenare, Gjykata Kushtetuese nuk gjeti elementë të një procesi jo të rregullt ligjor.

Ndryshe nga pretendimi i kërkuësve, gjatë shqyrtimit të çështjes rezultoi se Gjykata e Apelit Vlorë ka zbatuar plotësisht detyrën e caktuar në vendimin nr.1327, datë 24.11.1998 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Kasacionit. Këtë detyrë, kjo Gjykatë, e zbatoi duke thirrur Mina e Martha Naqon me cilësinë e të paditurve në çështje edhe pse Gjykata e Kasacionit e kishte lënë thirrjen e tyre në çmimin e saj.

Në kushtet kur Gjykata e Apelit ka plotësuar detyrën e caktuar prej Gjykatës së Kasacionit, nuk mund të bëhet fjalë për zhvillimin prej saj të ndonjë procesi të parregullt ligjor të parashikuar prej nenit 42/1 të Kushtetutës, sepse faktikisht nuk janë vërtetuar shkeljet e neneve 486 e 493 të Kodit të Procedurës Civile, të pretenduara nga kërkuësit, dispoza këto që sanksionojnë zbatimin e detyrueshëm të udhëzimeve dhe konkluzioneve të Gjykatës së Lartë, si dhe të vendimeve të saj për çdo çështje të së drejtës që është vendosur në to.

I pabazuar, rezultoi edhe pretendimi tjetër i kërkuësve lidhur me njëanshmërinë në marrjen e vendimit nr.293, datë 9.3.2000 të Gjykatës së Lartë, sepse në bazë të nenit 72/4 të Kodit të Procedurës Civile, pjesëmarrja për të dytën herë e gjyqtarëve në gjykimin e çështjes në të njëjtën shkallë gjykimi nuk përbën shkelje procedurale në kuptimin e parregullsisë së përbërjes të trupit gjykues. Gjyqtari, sipas kësaj dispozite, ndalohet të marrë pjesë në gjykimin e një çështje vetëm në rast se ka marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje në një shkallë tjetër të procesit dhe jo në të njëjtën shkallë gjykimi.

Edhe në këtë rast, meqënëse nuk u vërtetua shkelja e nenit 72/4 të Kodit të Procedurës Civile, pretenduar prej kërkuësve, pra nuk u vërtetuan shkelje procedurale në kuptim të parregullsisë në përbërje të trupit gjykues, Gjykata Kushtetuese konkludon se nuk ndodhemi para shkeljes së parimit të paanësisë në gjykim dhe zhvillimit të një procesi gjyqësor të parregullt të parashikuar prej nenit 42/1 të Kushtetutës.

Duke patur parasysh sa më sipër edhe referimi i kërkuësve në vendimet nr.43, datë 4.6.1999 dhe nr.19, datë 18.4.2000 të Gjykatës Kushtetuese është i gabuar, sepse këto vendime bëjnë fjalë për rastet kur gjyqtari ka shfaqur mendim për çështjen dhe është prekur parimi i paanësisë në gjykim.

Kërkuësit kanë pretenduar dhe atakuar vendimet e Gjykatës së Lartë edhe për mungesë të pjesës arsyetuese, si dhe për zhvillimin e procesit gjyqësor pa pjesëmarrjen e palëve në Dhomën e Këshillimit.

Ndryshe nga pretendimet e kërkuësve rezultoi se vendimet e Gjykatës së Lartë të dhëna për mosshqyrtim të çështjeve, janë të arsyetuara dhe në to, nuk gjenden elemente të procesit jo të rregullt ligjor.

Edhe problemi i mospjesëmarrjes së kërkuësve si palë gjatë shqyrtimit të çështjes në Dhomën e Këshillimit nuk përbën proces të parregullt ligjor, sepse sipas nenit 480 të Kodit të Procedurës Civile mospranimi i rekursit në Dhomën e Këshillimit vendoset nga Kolegji i Gjykatës së Lartë pa pjesëmarrjen e palëve. Rregulli i sanksionuar në këtë dispozitë nisët nga fakti se shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është seleksionues dhe i kufizuar në raste nga ligji, kështu, që s'ka të bëjë me shqyrtimin e rregullt gjyqësor të saj.

Në lidhje me pretendimet e fundit të kërkuësve për çështjen e vlerësimit të mendimit të ekspertëve për vlerësimin e deklarimeve të Mina Naqos, etj., Gjykata Kushtetuese çmon se këto pretendime kanë të bëjnë me vlerësimin e provave që është detyrë kryesisht e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Gjykata Kushtetuese, nisur nga raporti i saj me gjykatat e zakonshme arrin në përfundimin se pretendimet e kërkuësve që lidhen me vlerësimin e provave, pra me themelin e çështjes, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

V E N D O S I:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

KËRKESË

Kërkuese: Naile Bida, lindur më 1962 në Martinë dhe banuese, Komuna Levan Fier.

Objekti: Kërkon të shpallet i vdekur bashkëshorti im Gëzim Bida.

Për arsye ekonomike, bashkëshorti im vendosi të shkojë emigrant në Itali. Gjatë udhëtimit me gomone, për shkak të motit të keq, humbi jetën. Këtë fakt e kemi marrë vesh të nesërmen në lajmet e televizionit, si dhe nga media e shkruar. Që nga dita e ngjarjes deri më sot nuk kemi ndonjë fakt tjetër, përveçse të parit. Në këto rrethana, kërkoj të shpallet i vdekur bashkëshorti im Gëzim Bida.

KËRKUESE
Naile Bida

KËRKESË

Fiqirete Bardhi, kërkon të shpallet e vdekur nëna e saj Fatime Hysa.

KËRKUESE
Fiqirete Bardhi

Fletorja Zyrtare gjendet:

- Në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

U dorëzua për shtyp më 15.4.2002
Doli nga shtypi më 18.4.2002

Tirazhi: 4250 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë

